



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova –Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

REFERENCË:	89/17			
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) - Parashtruesit të ankesës <b>“INFO COM”</b> me seli në Prishtinë			
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP			
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit <u>Bullatovci</u>			
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar N.T. <b>“INFO COM”</b> me seli në Prishtinë, me numër protokollit 89/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit <b>“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”</b> , me nr. të prokurimit 208/17/149/121, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).			
Lokacioni:		Prishtinë	Data:	24.04.2017
PËR AKTIVITET				X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR				X
PËR KOMENTE				X
PËR INFORMIMIN TUAJ				X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it"**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues N.T. **"INFO COM"** me seli në Prishtinë, me numër protokollit 89/17.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Boulaku</i>	13.04.2017	14.04.2017	24.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit	<i>data e autorizimit të eksp.</i>	<i>data e fillimit të ekspertizës</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

### N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 29 mars 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE N.T “INFO COM” sh.p.k. me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë .  
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

### N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: N.T. “INFO COM” me seli në Prishtinë

#### *Pikat e Ankesës:*

- Shkelje e nenit 7 paragrafi 4 të LPP-së, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
- Shkelje e nenit 52 paragrafi 3, 4 dhe 7 të LPP-së, Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës;
- Shkelje e nenit 54 të LPP-së, Njoftimi i kandidatëve/ tenderuesve të eliminuar;
- Shkelje e nenit 56 të LPP-së, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Shkelje e nenit 61 të LPP-së, Tenderët Jo-normalisht të Ulët;
- Shkelje e nenit 72 të LPP-së, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
- Shkelje e pikës 9.2 të Dosjes së tenderit.

#### *Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:*

- AK i Ministrisë së Arsimit ka here shkelje të nenit 52 të LPP-së paragrafit 3 , 4 dhe 7 po e citojmë paragrafin 7 Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit.
- AK i Ministrisë së Arsimit ka bere shkelje të Neni 54 Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar pasi është dashur të na dërgoj me email siç e shihet këtu të gjithë OE jemi Jo normalisht të Ulte dhe të gjithë OE jemi të Eliminuar ky është vlerësim/njoftim i AK qe ka bere kjo s’mundet me qenë kështu.
- Se pari Autoriteti Kontraktues i Ministrisë së Arsimit i ka bere shkelje të nenit 7 pika 4 trajtimi i dhe barazimi jo-diskriminimi i OE, pasi nuk i ka trajtuar të gjithë njësoj gjatë procesit të vlerësimit të Ofertave.



- Autoriteti Kontraktuesi i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te nenit 59 te ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L 092, pasi nuk ka bere vlerësim objektiv ne përputhje me nenin 59.4, pasi Autoriteti kontraktues do te konsideroje një tender si te përgjegjshëm vetëm nëse tenderi ne fjale është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit .
- AK i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te nenin 59 pika 2, pasi autoriteti kontraktues mundet qe me shkrim te kërkoje nga një OE qe te siguroje një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit te tij, ne mënyrë qe te behet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve ne këtë raste ka mundur te kërkoj sqarime për referencën e dorëzuar.
- AK i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te pikës 9.1 te dosjes se tenderit, pasi ne si kompani i kemi plotësuar kriteret e kërkuar ne Dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për Kontrate ku dhe vlerësimi i tenderit duhet te behet sipas këtyre kriterëve te përcaktuar ne FTD dhe ne dosjen e tenderit.
- **AK i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te nenit 61 te LPP-se dhe rregullores Udhëzim Administrativ Nr. 3/2015, pasi duhet te na dërgoj njoftimin mbi arsyetimin te çmimit Jo normalisht te ulet.** Ne si Kompani kishim jep një Arsyetim për çmimet Jo normalisht te ulet dhe duhet ti men r parasysh shpjegimet e dorëzuara nga Tenderuesi shih nenin 61.2 dhe nenin 61.3 dhe 61.4.
- Gjithashtu Autoriteti Kontraktues nuk e ka njoftuar KRRPP për shpjegimet lidhur me eliminimin si Jo normalisht i ulet si qe e parashih neni 61. Pika 4 me këtë mundem me konkluduar se kjo është e qëllimshme.
- Autoriteti Kontraktues i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se pasi nuk ka bere vlerësim objektiv dhe real te ofertave, pasi OE i rekomanduar për kontrate nuk ka referencat me vlere siç e kane kërkuar ne dosje e tenderit ne përputhje me dëshmitë e kërkuar ne dosjen e tenderit te pikës 9.2.
- Gjithashtu ka bere shkelje te nenit 59 nuk ka bere vlerësim real pasi kompania "INFO COM" ka qenë me te lire edhe është ne kundërshtim edhe piken 31.1 e dosjes se tenderit: Tenderi i përgjegjshëm me **çmimin me te ulet.**
- AK i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, pasi AK duhet te sigurojnë dëshmitë për kualifikime minimale dhe te specifikuara ne dosjen e tenderit dhe Kompania rekomanduar për kontrate " **N.T.SH NORD**" nuk ka plotësuar referencat me çmime.
- AK i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te nenit 26. Pika 2 Kriteret e Përzgjedhjes pasi një OE i plotëson kërkesat minimale duhet te kualifikohet si i përgjegjshëm nga AK, pasi ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes.

- AK i Ministrisë se Arsimit ka bere shkelje te **Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave** te gjitha kontratat publike do te jepen, sipas procedurave te themeluara se pan, vlerësimit te tenderëve dhe kandidateve sipas kërkesave te kualifikimit te specifikuara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. te nenit 51 te këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike te kërkuara ne baze te nenit 28 te këtij ligji; 1.2. se dyti, vlerësimi i tenderëve ne përputhshmëri te kriterave te v e n d o s u r a n e n e n i n 6 0 t e k ë t i j l i g j i .
- AK i Ministrisë se Arsimit bërë shkelje nenit 72 te ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligj in Nr. 05/L 092 pasi ka mundur te kërkoj sqarimi për çmimet e dorëzuar ne kemi dorëzuar.
- Ka bere shkelje te nenit 39 te UDHEZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK
- Kompania "Info Corn shpk" është me e lira për nga çmimi dhe është dashur te rekomandohet për kontrate ne përputhje me nenin 60 te LPP-
- Gjithashtu kompania jone N.T. "INFO COM", ka pasur çmime te Arsyeshme dhe ne përputhje me Udhëzimin Administrativ dhe ne përputhje me nenin 61 te LPP-se .
- Gjithashtu Autoriteti Kontraktues nuk e ka njoftuar KRRPP për shpjegimet lidhur me eliminimin si Jo normalisht i ulet si qe e parasheh neni 61. Pika 4 me këtë mundem me konkluduar se kjo është e qëllimshme nga ana e AK.
- Kërkojmë nga OSHP-ja qe rasti te kthehet ne Rivlerësim pasi jemi kompania qe i plotësojmë k u s h t e t e k ë r k u a r n e d o s j e n e t e n d e r i t



## Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1).....	17.01.2017
Data e njoftimit për kontratë (N. 40) .....	09.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-.....	Procedura e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16): .....	Furnizim /e mesme
Vlera e përlogaritur për këtë prokurim (N.15-19): .....	: 100.000,00€
36muaj	
Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9): .....	
Afati kohor për pranimin e ofertave (gjithsejtë ditë): .....	06.03.2017

## Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60): .....	Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të ulët.
Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N.65-69):	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Operatori ekonomik duhet t'i përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65. 2.</li><li>- Dokument përkatës në vendin tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.<ul style="list-style-type: none"><li>- Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës</li></ul></li></ul>	
Dëshmitë dokumentare:	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).</li><li>- Vërtetimi nga Administrata Tatimore (kopje).</li><li>- Vërtetimi nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).</li><li>- Dokumentet (nën 2 dhe 3) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.</li></ul>	

*Kërkesat përshtatshmerisë profesionale (N. 66):*

- Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit.
- Certifikatë me numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për kompanitë vendore).
- Certifikatë e TVSH-së, (për kompanitë vendore).

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Certifikatë e regjistrimit të biznesit (kopje).
- Certifikatë me numër fiskal (kopje).
- Certifikatë e TVSH-së (kopje).

*Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së )*

- Qarkullimi bankarë për tri vitet e fundit duhet të jetë së paku 200,000.00 €
- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Vërtetimi nga ndonjë bankë, ose Pasqyrat financiare të audituara për tri vitet e fundit 2013,2014 dhe 2015

*Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së )*

- Se paku tre kontrata dhe referenca ne tre vitet e fundit (2013-2014-2015) ,në vlerë prej 150,000.00€

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Lista e shërbimeve, furnizimeve te realizuara ne tre vitet e fundit(2013-2014-2015), produktet e përfshira, shumat e kontratave, data dhe pranuesi,kopja e referencave për pajisje .

**Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):**

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	“GRAFO LONI”	Prishtinë	44,080.77€
2.	“NART GROUP”	Suharekë	75,307.60€
3.	“EURO PRINTY”	Prishtinë	55,702.16€
4.	“TRIO TEK”	Prishtinë	37,818.00€
5.	“GRAF TEK”	Prishtinë	38,134.06€
6.	“BOTEK”	Prishtinë	110,692.00€
7.	N.T.G. “BLENDI”	Prishtinë	37,883.66€
8.	“NORD”	Prishtinë	32,881.90€
9.	“IT MARKET”	Prishtinë	46,708.00€
10.	“INK STATION”	Ferizaj	36,011.00€
11.	“INFO COM”	Prishtinë	26,404.00€
12.	“INFOSOFT OFFICE”	Prishtinë	44,167.75€
13.	N.T.P. “OFFICE PRINTY”	Prishtinë	41,331.44€

*Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 4 (katër) OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, çmimi dhe vendi.*



#### Komisioni vlerësues pranë AK:

*Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.59).*

Autoriteti kontraktues me dt. 09 mars 2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje 3 (tre ) anëtarëve, si në vijim:

- Ardiana Shabaj, Kryetare e Komisionit
- Valon Alimusaj, Anëtar
- Vjollca Camaj, Anëtar
- 

*Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimit:.....15.03.2017*

*Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N.41):.....16.03.2017*

*Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):..... 24.03.2017*

#### Raporti i komisionit vlerësues:

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstaton se 13 (trembëdhjetë ) operator ekonomik që kanë ofertuar, në aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”**, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, 4 (katër) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 9 (nëntë) operator ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- OE N.T. “INFO COM” Prishtinë, duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon numrin e fletëve që shtypin tonerët e ofruar nga operatorët ekonomi, në rast të mos përmbushjes së numrit të kopjeve do të zëvendësohen tonerët. Duhet të ofrohet deklaratë e garacionit për tonerë. Çmimet e ofruar janë jo serioze gjegjësisht pozicioni çmimi për njësi janë 2 euro.
- OE “INK STATION” Ferizaj, për tonerët kompatibil duhet të ofrohet certifikata e cilësisë së kualitetit. Duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon modelin e tonerëve të cilët do të ofrohen ( original apo kompatibil). Duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon numrin e fletëve që shtypin tonerët e ofruar nga operatorët ekonomi, në rast të mos përmbushjes së numrit të kopjeve do të zëvendësohen tonerët. Duhet të ofrohet deklaratë e garacionit për tonerë.
- OE “TRIO TEK” Prishtinë, Duhet të ofrohet deklaratë e garacionit për tonerë.
- OE “BLENDI” Prishtinë, i mungon Pjesa C- Formulari i çmimit.



- OE N.T.G.I. "GRAFO LONI" Prishtinë, për tonerët kompatibil duhet të ofrohet certifikata e cilësisë së kualitetit. Duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon modelin e tonerëve të cilët do të ofrohen ( origjinal apo kompatibil). Duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon numrin e fletëve që shtypin tonerët e ofruar nga operatorët ekonomi, në rast të mos përmbushjes së numrit të kopjeve do të zëvendësohen tonerët. Duhet të ofrohet deklaratë e garacionit për tonerë.
- OE "IT MARKET" Sh.P.K. Prishtinë, lista e shërbimeve, furnizimeve të realizuar ne tre vitet e fundit (2013, 2014, 2015), produktet e përfshira, shumat e kontratave, data dhe pranuesi, kopja e referencave për pajisje.
- OE "EURO PRINTY" Sh.P.K Prishtinë, duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon modelin e tonerëve të cilët do të ofrohen ( origjinal apo kompatibil). Duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon numrin e fletëve që shtypin tonerët e ofruar nga operatorët ekonomi, në rast të mos përmbushjes së numrit të kopjeve do të zëvendësohen tonerët. Duhet të ofrohet deklaratë e garacionit për tonerë.
- OE "NART GROUP" Sh.P.K. Suharekë, duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon modelin e tonerëve të cilët do të ofrohen ( origjinal apo kompatibil). Duhet të ofrohet deklaratë e garacionit për tonerë.
- OE "BOTEK" Sh.P.K. Prishtinë, duhet të ofrohet një deklaratë e cila specifikon modelin e tonerëve të cilët do të ofrohen ( origjinal apo kompatibil). Duhet të ofrohet deklaratë e garacionit për tonerë.

Komisioni pas shqyrtimit të ofertave, me që operatorët ekonomik i kanë dorëzuar ofertat, vendosi që t'i vlerësoj të gjitha ofertat që janë dorëzuar. Rekomandon për shpërbllim të kontratës OE "NORD" Prishtinë, vlera 32, 881.90€.

#### **Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)**

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

##### ***Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).***

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit "**Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it**", me nr. të prokurimit 208/17/149/121, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muaj, furnizim, vlerë e madhe. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.



## **Sqarimi: Nr. 2**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “*AK i Ministrisë së Arsimit ka bere shkelje te Neni 54 Njoftimi i Kandidateve dhe Tenderuesve te Eliminuar pasi është dashur te na dërgoj me email siç e shihet këtu te gjithë OE jemi Jo normalisht te Ulte dhe të gjithë OE jemi te Eliminuar ky është vlerësim/njoftim i AK qe ka bere kjo s'mundet me qenë kështu*” ekspertja shqyrtues bazuar në shkresat e lëndës sqaron, autoriteti kontraktues ka ngarkuar Letrën standarde për tenderuesin/kandidatin e eliminuar, për operatorët ekonomik të eliminuar ( dt. 16.03.2017), duke dhënë arsyet e eliminimit të operatoreve ekonomik të cilëve ju ka adresuar letra standarde në fjalë.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike se a i është dërguar letra standarde për tenderuesin/kandidatin e eliminuar operatorit ekonomik ankues, OSHP me dt. 30 mars 2017, ka kërkuar nga tavolina ndihmëse e KRPP-së, të bëjë verifikimin nëse me dt. 15.03.2017, në ora 15:17:10, kur është publikuar titulli “B42 Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar” në attach a e ka pasur edhe dokumentin e bashkangjitur apo ka pasur ndonjë pengesë dhe vërtete operatorët ekonomik nuk kanë mundur ta hapin attachin ashtu siç kanë pretenduar ose dokumentit i është bashkangjitur publikimet ndonjë datë tjetër si përmisim.

OSHP-ja, me dt. 03 prill 2017, ka marrë përgjigje nga kompania “Infodom” Kroaci ( kontraktori për E-prokurimit), ku thuhet ndër të tjera: Nuk ka të dhëna në sistem se shfrytëzuesi ka dorëzuar dokumentet te operatorët ekonomik. Shfrytëzuesi vetëm ka ngarkuar dokumentet. Për secilin prej atyre dokumenteve, nëse e hapin listën nen “Dërgimi i dokumenteve”, lisat është e zbrazët.

Bazuar ne atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye se autoriteti kontraktues konform nenit 54 paragrafi 1.3 të LPP-së, ka qenë i obliguar që menjher ta njoftoj operatorin e ekonomik ankues, si tenderuesi të pa-suksesshëm, se ka paraqitur tender të përgjegjshëm, duke cekur karakteristikat dhe përparësitë përkatëse të tenderit fitues si dhe emrin e tenderuesit fitues, e jo një gjë të tillë ta bëjë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës.

## **Sqarimi: Nr. 3**

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet: “*AK i Ministrisë së Arsimit ka bere shkelje te nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, pasi AK duhet te sigurojnë dëshmitë për kualifikime minimale dhe te specifikuara ne dosjen e tenderit dhe Kompania rekomanduar për kontrate "N.T.SH NORD" nuk ka plotësuar referencat me çmime*”, bazuar në shkresat e lëndës ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në FTD, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka kërkuar: “*Lista e shërbimeve, furnizimeve te realizuara ne tre vitet e fundit(2013-2014-2015), produktet e përfshira, shumat e kontratave, data dhe pranuesi, kopja e referencave për pajisje*”, mirëpo operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës në këtë aktivitet të prokurimit ka ofertuar në konzercium me OE “RILINDJA” Skenderaj, ku anëtar i konzerciumit OE “RILINDJA” Skenderaj konfrom kërkesë së lartë cekur ka ofruar si dëshmi: Listën e furnizimeve të realizuar në 3 vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015), bashkangjitur kontrata dhe referencat me çmime.

Ekspertja shqyrtues bazuar ne nenin 71 paragrafi 4 të LPP-së, sqaron: “*Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo*



ndaj anëtarëve individual të grupit”, andaj operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës konform nenit 69 paragrafi 8 të LPP-së, mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjerë.

#### **Sqarimi: Nr. 4**

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet : “AK i Ministrisë së Arsimit ka bere shkelje te nenit 61 te LPP-se dhe rregullores Udhëzim Administrativ Nr. 3/2015, pasi duhet te na dërgoj njoftimin mbi arsyetimin te çmimit Jo normalisht te ulet. Ne si Kompani kishim jep një Arsyetim për çmimet Jo normalisht te ulet dhe duhet ti men r parasysh shpjegimet e dorëzuara nga Tenderuesi shih nenin 61.2 dhe nenin 61.3 dhe 61.4.”, ekspertja shqyrtues bazuar në nenin 61 i LPP-së, vlerëson se është drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që të konsideron një tender të dorëzuar me çmim jo normalisht të ulët apo jo. Ndërsa, në rastin konkret autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave, tenderin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankues e ka vlerësuar si ofertë të papërgjegjshëm për faktin se operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar dëshmi ashtu siç janë kërkuar në njoftimin për informata shtesë të dt. 24.02.2017, respektivisht nuk ka ofruar: Një deklaratë e cila specifikon numrin e fletëve që shtypin tonerët e ofruar nga operatorët ekonomi, në rast të mos përmbushjes së numrit të kopjeve do të zëvendësohen tonerët.

#### **Sqarimi: Nr. 5**

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së, ekspertja shqyrtues sqaron është përgjegjësi dhe drejtë e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarim me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tyre apo jo, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

#### **Mendimi i Ekspertit Shqyrtues**

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e “Furnizim me tonerë për nevojat e MASHT-it”, me nr. të prokurimit 208/17/149/121, si dhe duke pasur parasysh sqarimin nr. 2, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa të aprovohet vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për kontratë, të dt. 16 mars 2017.